REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr.2453/11 Prot.

Lushnje më, 18 / 03 /2024

PROJEKT - V E N D I M

Nr. 36 Dt. 18.03.2024

" PËR RREGJISTRIMIN E TROJEVE TË DHËNA PËR NDËRTIM NGA NJËSIA E QEVERISJES VENDORE TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË AGJENSINË SHTETËRORE TË KADASTRËS LUSHNJE"

Këshillit Bashkiak në mbledhjen e radhës në datë ___/___/2024 mbështetur në relacionin e paraqitur në mbështetje të *nenit 8 pika 2,neni 9 pika 1.2gërma"a"dhe"c",pika 1.6 gërma "a",neni 54 të* ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015*"Për vetëqeverisjen vendore"*,Vendimit nr.329,datë 22.05.2019 pika 2,pika 4,pika 6,gërma"a"pika 9.1,VKM nr.89 datë 13.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"neni 192 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë,paragrafi II rregjistrimi i P.P të bëhet në bazë të një akti publik,të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent,si edhe në raste të tjera të parashikuara në ligj" si edhe nenit 193/b të Kodit Civil **JU** :

PROPOZOJMË :

I. Të miratohet përfundimi i proçedurave të rregjistrimit të trojeve të dhëna për ndërtim nga njësia vendore, *sipas dokumentacionit përkatës të ndodhur në dosje për:*
   A. **Z.Pllumb Skraqi,**duke kryer pagesën e truallit në vlerën 51227.4 (pesëdhjetë e njëmijë e dyqind e njëzët e shtatë pikë katër) lek
   B. **Z.Astrit Guga,** duke kryer pagesën e truallit në vlerën 141193 (njëqind e dyzet e njëmije e njëqind e nëntëdhjetë e tre)lek

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lushnje ose personi i autorizuar prej tij për lidhjen e kontratës së privatizimit para noterit.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

KRYETARI I BASHKISË
ERISELDA SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com